



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

Nr. 2930 Prot.

Tiranë, më 13.11.2020

**Lënda:** Paraqitje amendamenti 24 orë përpara seancës plenare.

**Baza ligjore:** Neni 75, pika 4 Rregullore Kuvendi

**Drejtuar:** **Z. Gramoz RUÇI**  
**KRYETAR I KUVENDIT**

**I nderuar z. Kryetar i Kuvendit!**

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit, paraqes për shqyrtim në seancë plenare dy amendamente në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”, me përmbajtje si më poshtë:

1. “Në tabelën 1 të projektligjit, sipas referencës në nenin 11 të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021”, të bëhet një ndryshim, si më poshtë:

“Në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë shtohen shpenzimet korrente me 500 milionë lekë në programin “Menaxhimi i mbetjeve urbane”.

2. Rritja e totalit të shpenzimeve me 500 milionë lekë do të mbulohet nga rritja e të ardhurave tatimore nga TVSH me të njejtën vlerë.”.

Këto ndryshime të pasqyrohen në nenet e projektligjit.

**Deputeti propozues**



Klotilda Bushka

## RELACION

### PËR AMENDAMENTIN NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2021”

Kontrata për projektin “Për ndërtimin e Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimin e vend depozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike” financohet nga Këshilli i Ministrave dhe Bashkia Tiranë, bazuar në planin e përbashkët të angazhimit financiar për sasinë minimale të mbetjeve të trajtuara në Landfillin e Sharrës.

Detyrimet kontraktore të Këshillit të Ministrave, sipas planit të angazhimit, për 3 vitet e ardhshme, janë në vlerat si më poshtë:

Vitet	Detyrimet kontraktore në lekë
2021	818,062,500
2022	796,762,500
2023	918,360,000
<b>Totali</b>	<b>2,533,185,000</b>

Planifikimi për vitet 2019 dhe 2020, i pjesës takuese të Qeverisë, ka rezultuar me mungesa fondesh duke krijuar një detyrim të prapambetur prej 382 475 000 lekësh.


Në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021” janë planifikuar vetëm 100 000 000 lekë për vitin 2021, për këtë projekt. Ky parashikim e vendos Bashkinë e Tiranës në pamundësi për përmbushjen e detyrimeve kontraktore për menaxhimin e mbetjeve urbane.

Për këtë arsye, në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”, propozojmë dy ndryshime, si më poshtë:

“1. Në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të shtohen shpenzimet korrente me 500 milionë lekë në programin “Menaxhimi i mbetjeve urbane”.

2. Rritja e totalit të shpenzimeve me 500 milionë lekë do të mbulohet nga rritja e të ardhurave tatimore nga TVSH me të njejtën vlerë.”.

Deputeti propozues



Klotilda Bushka